



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**URDHER**

**Nr. 53, Date 11.03.2020**

**PËR**

**USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SE ENTIT RREGULLATOR TE ENERGJISE DHE  
ZHVILLIMIN E MBLEDHJEVE APO SEANCAVE DEGJIMORE**

Mbeshtetur ne Vendimin e datës 09.03.2020 te Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Perhapur nga Coronavirusi i ri, në kushtet kur eshte deklaruar edhe mbyllja e të gjitha institucioneve arsimore ne mbare vendin, me qellim mbrojtjen e shendetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019, dhe me autoritetin e dhene nga Ligji nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, i ndryshuar si dhe ate nr.102/2015 “Per Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar

**V E N D O S A**

1. Pezullimin e veprimtarisë se ERE-s qe lidhet me zhvillimin e mbledhjeve te hapura te Bordit, zhvillimin e seancave degjimore teknike apo publike, si dhe pritjen e ankesave te klienteve te energjise elektrike apo gazit natyror, ne ambientet e ERE-s për shkak te situatës se krijuar nga infeksioni i përhapur Covid-2019.
2. Përjashtohen nga efektet e ketij pezullimi vendimmarrjet e bordit te ERE qe per shkak te rendesise dhe afateve se tyre duhen shqyrtuar ne kohe. Ne cdo rast, mbledhjet e Bordit per qellime te ketyre vendimmarjeve do te zhvillohen pa prezencen e publikut dhe duke perdorur mjetet konvencionale te teknologjise se komunikimit.
3. Kohëzgjatja e pezullimit, parashikuar në pikën 1 të këtij urdheri, të jetë deri me daten 23.03.2020 nga hyrja në fuqi e ketij urdheri.
4. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare te internetit të ERE

**Kryetari i ERE  
Petrit AHMETI**